

**Nr. 3 Regj.****Durrës, më 05.02.2026****Lënda:** Në përgjigje të kërkesës suaj.

### **Emër MBIEMËR**

Në kuadër të implementimit të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 30.01.2026, me objekt “Kërkesë për informacion mbi ecurinë e zbatimit të projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore “Durrës- Tiranë- Rinas” dhe komponentëve të tjerë plotësues.”, e regjistruar në regjistrin e “Kërkesë/Ankesë/Përgjigje” në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me numrin rendor 3 (tre), ju informojmë për si vijon:

#### **1. Në cilën fazë janë aktualisht punimet që po realizohen në linjën hekurudhore “Durrës - Tiranë – Rinas”? Sa përqind e punimeve janë realizuar deri më tani?**

Aktualisht janë të realizuar 90 (nëntë dhjetë) % të punimeve civile të kontratës së parë të punimeve ndërtimore të projektit “Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës-Terminali i Transportit Publik Tiranë (PTT) dhe ndërtimi i Linjës së Re Hekurudhore në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA).

#### **2. Disa ditë më parë u shëmb godina e vjetër e stacionit të trenit në Durrës. A do të ndërtohet një godinë e re dhe nëse po, çfarë funksioni do të ketë ajo? Detaje nga projekti nëse do të ndërtohet godina e re (vlera e investimit, sa kate do të jetë godina etj)**

Kontrata e Ndërtimit të stacioneve hekurudhore dhe sistemimit të shesheve të jashtme është një kontratë më vete, e cila ka filluar zbatimin në Prill të vitit 2025. Godina e stacionit të Durrësit, e cila u shëmb disa ditë më parë ishte plotësisht e amortizuar dhe e dëmtuar nga tërmeti i vitit 2019. Vlen të saktësojmë se në të njëjtin vend do të ndërtohet një godinë e re e njëjtë në arkitekture me të vjetrën, kjo ndërtesë do të funksionojë si godinë stacioni hekurudhor. Godina e re e pasagjerit në Durrës, sikurse edhe godina e re administrative dhe e mirëmbajtjeve teknike, ndodhur në stacionin hekurudhor Durrës (pra dy objekte në stacionin hekurudhor të Durrësit) sëbashku dhe me shtatë godinat tërësisht të reja, në të gjitha stacionet e tjera përgjate linjës hekurudhore, janë një investim totalisht modern, eficient dhe i qëndrueshëm, me një cilësi materialesh sipas standarteve të nivelit evropian, me vlerë 10 (dhjetë) milion euro. Në këtë vlerë janë përfshirë edhe të gjitha sheshet e jashtme, gjelbërimet, parkimet dhe sistemi fotovoltaik i paneleve diellor në secilen godinë.

### **3. Çfare funksioni do te ketë godina e re që po ndërtohet në krah të godinës së vjetër?**

Godina e re, që po ndërtohet pranë Stacionit Hekurudhor Durrës, është projektuar të funksionojë si godinë për administratën hekurudhore duke përfshirë dhe ambiente teknike te kontrollit të operimit të trenave.

### **4. Me ndërtimin e godinave të reja, a do të vazhdojë të jetë në funksion godina e Drejtorisë së Përgjithshme? Nëse jo, çfare do të ndodhë me atë?**

Godina e Drejtorisë së Përgjithshme, do të vijojë të jetë plotësisht funksionale dhe me ndërtimin e godinave të reja, pasi teknologjia e re që do të implementohet për qarkullimin e trenave do të kërkojë përveç stafit ekzistues dhe staf shtesë të trajnuar, të cilët do të akomodohen me zyra në godinën e re administrative në stacionin e Durrësit.

### **5. A ka nje afat konkret se kur do te vihet në funksion linja hekurudhore?**

Duke marrë në konsideratë të gjithë komponentët shtesë, të cilët kanë shtyrë afatet fillestare të vënies në funksion të linjës hekurudhore, si vonesat në procedurën e shpronësimit, ndërtimin e godinave të reja të stacioneve hekurudhore si dhe elektrifikimin e plotë të linjës hekurudhore të paparashikuara në kontratën fillestare, synohet që linja hekurudhore “Durrës-Terminali i Transportit Publik Tiranë (PTT) dhe ndërtimi i Linjës së Re Hekurudhore, në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)”, të fillojë operimin gjatë tremujorit të parë të vitit 2027.

### **6. A kanë përfunduar sistemet e sinjalizimit dhe të elektrifikimit përgjatë linjës hekurudhore?**

Vendosja e sinjalistikës hekurudhore dhe pse është pjesë e kontratës së parë të projektit “Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës-Terminali i Transportit Publik Tiranë (PTT) dhe ndërtimi i Linjës së Re Hekurudhore, në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA), lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me ndërtimin e godinave të stacioneve tek të cilat do të instalohen pajisjet e sinjalistikës. Pajisjet elektromekanike të jashtme dhe të brëndshme për sistemin e sinjalizimit, janë në proces zbatimi dhe do të perfundojnë tërësisht brenda 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2026. Ky proces do pasohet me fazën e komisionimit dhe testimeve deri në fund të vitit 2026.

Ndërsa lidhur me elektrifikimin e linjës hekurudhore, aktualisht procedura është në tenderim ndërkombëtar nga ana e BERZH dhe ende nuk ka filluar implementimi i këtij komponenti/ kontrate të ri/e, me një kontraktor të ri punimesh.

**7. Deri me tani sa është vlera e përgjithshme e investimit dhe a parashikohet në të ardhmen fonde të tjera shtesë për këtë linjë? Nëse po, për çfarë do të përdoren?**

Financimi fillestar u sigurua nëpërmjet një marrëveshjeje kredie me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në vlerën 36.87 milionë euro, si dhe një granti nga WBIF/BE në shumën 35.435 milionë euro, duke e çuar financimin fillestar në rreth 72.3 milionë euro (69.69 mil euro investimi i punimeve dhe pjesa tjetër asistencë teknike dhe supervizioni i punimeve)

Më pas, u miratua një financim shtesë përmes një kredie tjetër nga BERZH në vlerën prej rreth 40.7 milionë euro, e ratifikuar me ligjin nr. 1/2025. Ky financim shtesë mbulon indeksimin e çmimeve (29 mil), ndërtimin e godinave të reja të stacioneve hekurudhore (10.5mil euro) dhe supervizionin e punimeve sëbashku me asistencë teknike (1.2mil euro).

Në total, vlera e përgjithshme e investimit dhe asistencave teknike për projektin arrin në 113 milionë euro.

Parashikohet gjithashtu dhe një shtesë prej rreth 25 mln Euro në trajtë granti dhe kredie (50% + 50%), e cila do të përdoret për projektin e elektrifikimit të linjës hekurudhore “Durrës-Terminali i Transportit Publik Tiranë (PTT) dhe ndërtimi i Linjës së Re Hekurudhore, në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)

Bashkëlidhur do gjeni foto nga projekti për ndërtimin e godinave të reja në Stacionin Hekurudhor Durrës.

\*Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të Drejtën e informimit” (i ndryshuar) dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Me konsideratë!

**KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT**  
**Domeniko SINJARI**























